



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7484 / prot. 1/1

Tiranë, më 21 . 12 . 2023

UDHËZIM

Nr. 24 , datë 21 . 12 . 2023

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015 "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të shkronjës "d" të pikës 8 të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", të ndryshuar.

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit", të ndryshuar të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Shkronja "k" e pikës 4, shfuqizohet.

b) Në shtojcën nr. 1, pas profilin me numër rendor 24, të shtohen profilet me numër rendor 25 dhe 26 si më poshtë:

"25. *Arte skenike, kodi 25;*

26. *Koreografi, kodi 26.*"

c) Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, të udhëzimit nr. 10, datë 3.4.2015, i ndryshuar, zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
OGERTA MANASTIRLIU



SHTOJCA NR 2

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. ID (Kartë identiteti/pasaportë)	ZVAP	Data lindja	Vendndija	Viti i diplomimit	Institucioni i Arsimit të Lartë	Fakulteti	Diploma bachelor	Diploma Master	Profili	Titulli

Adresa: "Rrugë e Durrësit", Nr. 23, A.L. 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Qendra e Shërbimeve Arsimore

Licencë

PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT NË PROFILIN

I lëshohet / /Z/ nj. _____ në s' zbatim të _____
(Emër, Atest, Mfletore) (Dadimaja) (Vendimaja)

ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas përfundimit të studimeve të ciklit të dytë Master në _____ kryesjes me sukses të praktikës profesionale dhe kalimit në provimin e shtetit në datën _____

Drejtori i Përgjithshëm

Data xx xx xxxx

Numri i licencës: xxxxxxxxxx